

V E N D I M
Nr. 676, datë 20.12.2002

PËR SHPALLJEN ZONË E MBROJTUR TË MONUMENTEVE TË NATYRËS SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 7 dhe 13 të ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 100, datë 19.5.1981, "Për vënien nën mbrojtjen shtetërore të pasurive natyrore të rralla", shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, strukturat e saj, Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve, e Kullotave dhe Drejtoria e Peshkimit, si dhe organet e qeverisjes vendore, ku ndodhen këto monumente të natyrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano